



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

---

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/2013 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë publikon:

**SHPLLJEN PUBLIKE**  
**PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS**

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar të cilët dëshirojnë që të aplikojnë për dhënien e provimit të jurisprudencës ne afatin e Marsit 2016 se:

Afati për dorëzimin e aplikacioneve për dhënien provimit të jurisprudencës fillon prej datës **08 Shkurt 2016** deri me datë **15 Shkurt 2016**.

Kërkesës për dhënien e provimit të jurisprudencës, duhet t'i bashkangjesin dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmohet se i plotëson kushtet ligjore, si në vijim;

- Dëshminë për përfundimin e Fakultetit Juridik, sipas programit katër vjeçar, ndërsa kandidatet me studime tre vjeçare, duhet ti kenë te përfunduara edhe studimet master;
- Dëshminë për përvojën e punës juridike pas diplomimit konform Ligjit të jurisprudencës, kontratën e punës dhe vërtetimin e marrëdhënies së punës.
- Certifikatën e shtetësisë të Republikës së Kosovës;
- Nëse fakulteti është kryer në shtetin tjetër, atëherë kandidati duhet ta sjell diplomën e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës.

Kandidatët të cilët kanë mbetur në riprovim nga afati i Dhjetorit 2015 duhet ta paraqesin kërkesën brenda këtij afati për të ju nënshtruar Riprovimit ne afatin e Marsit 2016.

Kandidatëve të cilëve me parë ju është aprovuar kërkesa për dhënien e provimit të Jurisprudencës, e të cilët dëshirojnë t'i nënshtrohen Provimit në këtë afat, duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e provimit të jurisprudencës, e cila duhet të përmbajë të dhënat personale dhe vitin në të cilin ju është lejuar dhënia e provimit të Jurisprudencës.

Kërkesa për dhënien e provimit të jurisprudencës dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, Ish-Ndërtesa e Rilindjes Kati përdhese Arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri 16.00.

Kandidatit me vendim i lejohet hyrja në provimin e jurisprudencës.

Për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së provimit me shkrim dhe me gojë kandidatët do të njoftohen përmes njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

**Për informata të hollësishme mund të drejtoheni në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë <http://www.md-ks.org>, apo kontaktoni në, tel: 038 200 18 353.**